


THIRRJE PËR PROJEKT PROPOZIME PËR GRANTE

Nr. 062024

TITULLI I PROJEKTIT:

“SHFRYTËZIMI I QËNDRUESHËM I BURIMEVE NATYRORE PËR ZHVILLIMIN NDËRKUFITAR SOCIO-EKONOMIK TË ZONAVE TË MBROJTURA NË MAQEDONINË VERIORE DHE SHQIPËRI (KORAB-KORITNIK, SHARR DHE ALPET SHQIPTARE)”

Kjo Thirrje për Projekt Propozime për Grante është e hapur për Organizatat Joqeveritare të përfshira në aktivitetet e konservimit të natyrës, menaxhimit të burimeve natyrore në kufijtë administrativ të bashkive Fushë Arrëz dhe Mirditë për zhvillimin e aktiviteteve në korridoret ekologjike të fokusuar në brezin e lidhjes Cukal-Munelle-Balgaj-Martanesh. Zona e fokusuar e shënuar me të verdhë në hartën e mëposhtme:



Vështrim i përgjithshëm

CNVP është një organizatë hollandeze që operon në Ballkan. Misioni ynë është të promovojmë përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe të ofrojmë mbështetje për komunitetet dhe qeverisjen lokale në krijimin e një jete në harmoni me natyrën. Nëpërmjet projekteve të ndryshme, ne synojmë të kontribuojmë për një Europë më të mirë në pjesën Juglindore duke u fokusuar në gjashtë fusha kryesore:

1. Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore
2. Ndryshimi i klimës
3. Zhvillimi rural
4. Energjia e rinovueshme
5. Mobilizimi i komunitetit
6. Aderimi evropian

CNVP, përmes degëve të saj në Maqedoninë e Veriut dhe Shqipëri, po zbaton një projekt trevjeçar “**Përdorimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore për zhvillimin ndërkufitar socio-ekonomik të zonave të mbrojtura në Shqipëri dhe Maqedoninë e Veriut** (Korab-Koritnik, Sharr dhe Alpet Shqiptare)”, financuar nga Prespa Ohrid Nature Trust (PONT).

Në zbatimin e këtij granti, CNVP bazohet në përvijën e saj në Prespë të mbështetur

nga PONT, si dhe në punën e saj të gjerë në vendet e Ballkanit gjatë shumë viteve me mbështetjen e donatorëve të tjerë.

Projekti synon të përmirësojë kushtet socio-ekonomike të komuniteteve lokale, duke kontribuar në ruajtjen e natyrës. Ai fokusohet veçanërisht në përdorimin e qëndrueshëm të produkteve pyjore jo-drunore (PPJD) dhe turizmin e bazuar në natyrë, duke përdorur një qasje pjesëmarrëse, ndërkufitare dhe ndërsektoriale.

Për më tepër, ne do të zbatojmë një program të vogël grantesh për OJQ-të lokale dhe shoqatat e përdorimit të burimeve natyrore, për të promovuar dhe pilotuar qasje dhe praktika të reja në korridoret ekologjike sipas një studimi të veçantë të PONT. Kjo do të shoqërohet me aktivitete ndërgjegjësuese dhe ngritjen e kapaciteteve, lehtësimin e pjesëmarrjes lokale në ruajtjen e natyrës, si dhe krijimin e mekanizmave efektivë të qeverisjes.

Projekti ka tre objektiva kryesore:

1. Përdorimi i qëndrueshëm i PPJD në zonat e mbrojtura të Sharrit, Korab-Koritnik dhe Alpeve Shqiptare, duke kontribuar si në ruajtjen e natyrës ashtu edhe në zhvillimin e komunitetit lokal në këto Zona të Mbrojtura.
2. Turizmi i bazuar në natyrë në zonat e mbrojtura të Sharrit, Korab-Koritnik dhe Alpeve Shqiptare, duke kontribuar si në ruajtjen e natyrës ashtu edhe në zhvillimin e komunitetit lokal në këto Zona të Mbrojtura.
3. Zhvillimi i një mekanizmi qeverisës në Sharr, Korab-Koritnik dhe Alpet Shqiptare për të mundësuar turizmin e bazuar në natyrë dhe shfrytëzimin e burimeve të tjera natyrore të qëndrueshme në këto Zona të Mbrojtura:

Grantet janë të destinuara kryesisht për OJQ-të e kualifikuara me prezencë lokale në bashkitë Fushë Arrëz dhe Mirditë për të zhvilluar aktivitete në korridoret ekologjike të fokusuar në Cukal-Munelle-Balgjaj-Martanesh. Aktivitetet e pranueshme përfshijnë pjesëmarrjen e qytetarëve në përpjekjet për ruajtjen, zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërisë dhe komuniteteve lokale dhe nxitjen e përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore.

Thirrjet e hapura për grante do të reklamohen në faqen e internetit të CNVP dhe rrjetet sociale të organizatës.

Fusha e thirrjes

Qëllimi kryesor është: Ruajtja e natyrës për një të ardhme të qëndrueshme nëpërmjet partneriteteve dhe financimeve afatgjata.

Kjo Thirrje për Projekt Propozime për Grante është e hapur për OJQ-të, aktive në territorin administrativ të bashkive Fushë Arrëz dhe Mirditë me mision ruajtjen e natyrës, mbrojtjen e mjedisit, forcimin e organizatave lokale, ndërgjegjësimin e komunitetit për ruajtjen e burimeve natyrore dhe menaxhimin e qëndrueshëm të natyrës në Zonat e Mbrojtura.

Shtirja gjeografike e kësaj thirrje është e kufizuar në zonën e së lidhjes së korridorit ekologjik Cukal-Munelle-Balgjaj-Martanesh.

Kualifikimi i aplikantëve

Projekt propozimet në kuadër të kësaj thirrjeje do të dorëzohen nga OJQ vendore të fokusuar në propozime që kanë ndikim në ruajtjen, korridoret ekologjike, si dhe zbatimin e parimeve dhe praktikave sipas modeleve të qëndrueshmërisë ekologjike që plotësojnë kriteret dhe **janë aktive në territorin e bashkive të Fushë Arrëzit dhe Mirditës**. Për qëllime të kësaj Thirrjeje, aplikanti i kualifikuar duhet të ketë statusin e duhur ligjor sipas ligjit shqiptar, të jetë i regjistruar në tatim-taksa, të mos ketë detyrime fiskale të papaguara dhe të ketë një llogari bankare aktive. Misioni i deklaruar i OJQ-së aplikuese duhet të përfshijë mbrojtjen dhe/ose ruajtjen e natyrës, ndërgjegjësimin e komunitetit në përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore.

Ju lutemi vini re se aplikantët që aktualisht po zbatojnë projekte me financime nga PONT nuk kanë të drejtë të aplikojnë për këtë thirrje. Aplikantët që janë partnerë në çdo aplikim me PONT kanë të drejtë dhe mund të aplikojnë për këtë thirrje.

Aplikantët në të cilët personeli i Zonave të Mbrojtura është i përfshirë si anëtar i bordit dhe menaxhimit ose veprojnë si staf/ekspertë të bizneseve/fermereve, OJQ-ve nuk kanë të drejtë të aplikojnë.

Aktivitetet e pranueshme

Skema e nëngranteve mund të ofrojë mbështetje për aktivitetet e mëposhtme:

- Rritja e ndërgjegjësimit dhe organizimi i sesioneve informuese me palët e interesuara lokale mbi korridoret ekologjike/lidhëse, rëndësinë e tyre, rolin e aktorëve etj.
- Identifikimi i pikave të nxehta dhe mundësive për masa të tjera efektive të ruajtjes së natyrës dhe përgatitja e hartave përkatëse.
- Identifikimi i vendeve të mundshme dhe instalimi i kamerave kurth për monitorimin e kafshëve të egra në zonë
- Futja e sistemeve të reja të ngrohjes që reduktojnë konsumin e druve të zjarrit në ndërtesat publike të rehabilituara të cilat janë brenda korridoreve ekologjike

Aplikimi për një Grant

Aplikantët duhet të dorëzojnë projekt propozimin sipas formateve dhe manualit bashkangjitur kësaj shpallje. Modeli i aplikimit dhe kërkesat e detajuara gjenden në faqen e internetit të CNVP: <http://cnvp-eu.org>

Shuma maksimale e grantit është 20.000 Euro.

Afati kohor i zbatimit të grantit është **9 muaj**, nga muaji **Tetor 2024 deri në fund të qershorit 2025**.

Afati i fundit për paraqitjen e aplikimit

Aplikantët e interesuar duhet të dorëzojnë projekt propozimet e tyre në mënyrë elektronike në adresën isuf.omuri@cnvp-eu.org jo më vonë se data **22.09.2024** në orën 24:00.

Për të aplikuar për një grant sipas kësaj Thirrje, ju lutemi plotësoni **dokumentat e aplikimit** të disponueshëm [këtu](#)

Gjatë periudhës së thirrjes së hapur për grante, aplikantët e mundshëm mund të bëjnë pyetje në lidhje me dokumentacionin që duhet të dorëzohet. Ju lutemi dërgoni pyetjet tuaja deri më **20 Shtator 2024 deri në orën 16:00**.

Të gjitha pyetjet nga aplikantët mund të dërgohen në adresën e e-mailit isuf.omuri@cnvp-eu.org

Procesi i rishikimit dhe hapat e mëtejshëm

Procesi i shqyrtimit të projekt propozimit do të zgjasë afërsisht 7 ditë nga data e përfundimit të afatit të dorëzimit. Komisioni i vlerësimit do të zgjedhë projekt propozimet më të mira që plotësojnë kriteret e pranueshmërisë të përshkruara më sipër. Vetëm aplikanti/ët fitues do të marrin një përgjigje që përshkruan hapat e mëtejshëm për projekt propozimin e tyre.